



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KËSHILLI

Nr. 3156/5 Prot.

Pogradec, më 16.07.2023

VENDIM

NR 85, DATË 11.07.2023

“PËR RINOVIMIN E KONTRATAVE PËR AMBIENTET DHE OBJEKTET E MARRA
ME QIRA, TË CILAT KANË SHËRBYER SI KOSHTE DHE SHKOLLA NË
BASHKINË POGRADEC ”

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, në shkronjën "b" dhe shkronjën "gj" të nenit 64 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në Ligjin Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.83, datë 19.07.2022”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 20.09.2022”, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative përkatëse,

KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:

1. Të rinovohen kontratat e lidhura në vitin 2022 nga Bashkia Pogradec për ambientet e marra me qera në kuadër të funksionimit të tyre si objekte që kanë shërbyer si kopshte dhe çerdhe.
2. Për kontratën e lidhur në vitin 2022 për fshatin Kalivaç, në Njësinë Administrative Trebinjë, nuk do të ketë rinovim kontrate për vitin 2023-2024 pasi Qendra Arsimore Pogradec nuk ka nevojë për marrje me qira të ambientit për shkak të mbylljes së kopshtit nga mungesa e fëmijëve.
3. Rinovimi i këtyre kontratave të hyjë në fuqi më datë 01.09.2023, që korrespondon me fillimin e Vitit të Ri shkollor 2023-2024 dhe do të zgjasë deri më 01.07.2024.
4. Vlerat e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara. Vlerat e qerasë mujore për secilën Njësi Administrative janë si mëposhtë:
 - 4.1 Fshati **Selcë e Poshtme** në *Njësinë Administrative Proptisht*. Ambienti shërben si shkollë bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.83 datë 19.07.2022 me vlerë qeraje 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

- 4.2 Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambjenti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101 datë 20.09.2022, me vlerë qeraje 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
- 4.3 Fshati **Buzaishtë** në *Njësinë Administrative Velçan*. Ambjenti shërben si shkollë (arsim fillor), bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101 datë 20.09.2022, me vlerë qeraje 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
- 4.4 Fshati **Stropckë** në *Njësinë Administrative Dardhas*. Ambjenti shërben si kopësht bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.83 datë 19.07.2022, me vlerë qeraje 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

Mbështetur në Vendimet e sipërpërmendura të Këshillit të Bashkisë Pogradec do të lidhen kontratat për vitin e ri arsimor 2023 – 2024.

5. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e bashkisë Pogradec.
6. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

